



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -032

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.03/L-199 PËR
GJYKATAT**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.03/L-199
PËR GJYKATAT**

Neni 1

Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6., pas fjalës “Departamentit”, fshihet fjala “të Përgjithshëm”.

Neni 2

Neni 6 i ligjit bazik, pas paragrafit 2, shtohet paragrafi i ri 3, me tekstin si në vijim:

3. Gjykatat publikojnë aktgjykimet e plotëfuqishme në faqe të tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e arritjes së plotëfuqishmërisë së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli), duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 3

Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2, pas nënparagrafit 2.4, shtohen nënparagrafët e ri 2.5., 2.6., dhe 2.7. me tekstin si në vijim:

2.5.dega në Fushë Kosovë për Komunën e Fushë Kosovës dhe Komunën e Obiliqit;

2.6 dega në Junik për Komunën e Junikut”

2.7. dega në Shtime për Komunën e Shtimes”

Neni 4

Neni 13 i ligjit bazik, pas paragrafit 2 shtohet një paragraf i ri 3. me tekstin si në vijim:

3.në kuadër të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë funksionon Divizioni për kontestet lidhur me investitorët e huaj, me juridiksion për tërë territorin e Kosovës.

Neni 5

Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.21 riformulohet me tekstin si në vijim:

1.21. çfarëdo krimi tjetër i dënueshëm mbi dhjetë (10) vite, siç përcaktohet me ligj.

Neni 6

Neni 19 ti ligjit bazik , paragrafi 2 fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 7

Neni 24 i ligjit bazik fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 8

Neni 26 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 26

Kushtet për emërimin e gjyqtarëve

1. Kandidatët për t'u emëruar gjyqtar, siç parashihet ne nenin 104 dhe nenin 108 te Kushtetutës se Republikës se Kosovës, duhet plotësuar kushtet e përgjithshme si në vijim:

1.1.të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

1.2. të ketë diplomën e fakultetit juridik të vlefshëm në Kosovë;

1.3.të ketë të kryer provimin e jurisprudencës të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë;

- 1.4. të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal;
- 1.5. të mos jetë i dënuar për vepër penale;
- 1.6. të ketë së paku tre (3) vite përvojë në fushën juridike, dhe
- 1.7. të ketë kaluar provimin për gjyqtar, në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli.

2. Për qëllime të këtij neni përvoja në fushën juridike përfshin përvojën në çështje juridike në institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, përvojën si noter dhe përmbarues privat.

Neni 9

Neni 27 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 27 Kushtet për gjyqtarë

1. Pas emërimit nga Presidenti i Kosovës, këta gjyqtarë, me përjashtim të atyre që kanë përvojë paraprake si gjyqtar, do t'i nënshtrohen trajnimit fillestar, i cili do të organizohet nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. Trajnimi fillestar do të zgjasë dymbëdhjetë (12) muaj, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Gjatë trajnimit fillestarë gjyqtarëve nuk do t'u caktohen raste.
3. Gjyqtarët e emëruar do të vlerësohen pas rezultateve të trajnimit fillestar, në përputhje me dispozitat relevante të këtij ligji. Periudha e trajnimit fillestar do të vazhdohet për ata gjyqtarë që dështojnë të përfundojnë në mënyrë adekuate trajnimin fillestar, siç është përcaktuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës.
4. Përveç kualifikimeve minimale, të gjithë kandidatët për emërim për gjyqtarë, me qëllim të emërimit apo avancimit në gjykata duhet të kenë kualifikimet si në vijim:
 - 4.1. për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin për Krime të Rënda apo për të Mitur në Gjykatën Themelore, kandidati duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë si gjyqtar në lëmin penal apo prokuror;
 - 4.2. për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin e Çështjeve Administrative ose Departamentin e Çështjeve Ekonomike të Gjykatës Themelore, gjyqtari duhet të ketë së paku gjashtë (6) vite përvojë në fushën juridike duke përfshirë edhe përvojën në çështjet administrative dhe ekonomike.
 - 4.3. për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit, gjyqtari duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë si gjyqtar.

4.4. për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Supreme, gjyqtari duhet të ketë së paku tetë (8) vite përvojë si gjyqtar.

Neni 10

Pas nenit 28 të ligjit bazik shtohet neni i ri 28/A me tekstin si në vijim:

Neni 28/A Përfundimi i mandatit

1. Mandati i gjyqtarit përfundon me:

- 1.1. dorëheqje;
- 1.2. shkarkim;
- 1.3. vdekje,
- 1.4. me arritjen e moshës të pensionimit;
- 1.5. nëse nuk rrimërohet me mandat të përhershëm.

Neni 11

1. Neni 29 i ligjit bazik, paragrafi 1.1, pas fjalës “një pagë”, fshihen fjalët “ekuivalente me atë të “ dhe zëvendësohen me fjalët “jo më pak se ajo e”.

2. Neni 29 i ligjit bazik, paragrafi 1.2, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.2. Gjyqtari i Gjykatës Supreme do të pranoj pagën në shkallë prej nëntëdhjetë përqind (90%) të pagës së Kryetarit të Gjykatës Supreme;

3. Neni 29 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet si në vijim:

3. Gjyqtarët gëzojnë të drejten e pushimit vjetor në pajtim me Ligjin e Punës.

Neni 12

Neni 32 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 32 Veprimtaritë Profesionale

1. Gjyqtaret kanë të drejtë që me aprovimin e Këshillit të marrin pjesë në organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të gjyqtarëve.

2. Gjyqtarët, jashtë orarit të punës, me vendim të Këshillit mund të angazhohen në veprimtari të cilat janë në përputhje me Kodin e Etikës dhe sjelljen profesionale të gjyqtarëve

3. Në pajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale të gjyqtarëve, gjyqtarët mund të angazhohen në shkrime profesionale dhe shkencore, por nuk mund të botojnë përmbajtjen relevante të dosjeve gjyqësore gjatë apo pas përfundimit të funksionit gjyqësor, përveç nëse kjo lejohet shprehimisht me ligj apo akt nënligjor të lëshuar nga Këshilli.

4. Gjyqtaret që pranojnë shpërblim për këto aktivitete, nuk mund të tejkalojnë vlerën prej njëzet e pesë përqind (25%) të pagës bazë, për pjesëmarrje në veprimtaritë e parapara sipas këtij neni dhe për këtë shpërblim e njoftojnë Këshillin.

Neni 13

1. Titulli i nenit 33 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

“Bashkëpunorët profesional, praktikantët, përkthyesit, interpretët dhe ekspertët gjyqësor”.

2. Neni 33 i ligjit bazik pas paragrafit 1, shtohet paragrafi i ri 2. me tekstin si në vijim:

2.Këshilli me rregullore të veçantë përcakton procedurat e emërimit, kushtet, të drejtat dhe detyrimet për përkthyes, interpret dhe ekspert gjyqësor, si dhe lartësinë e shpërblimit për punën e tyre.

Neni 14

Pas nenit 42 të ligjit bazik shtohet neni i ri 42/A, me tekstin si në vijim:

Neni 42/A Dispozitat Kalimtare

Statusi i stafit administrativ i nënshtrohet parimeve të shërbimit civil dhe do të rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 15 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -032
28 maj 2015**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI